


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
STUDIO NOTERIALE BLERTA ELEZI (PEKU)

NR 209 REP

NR 679 KOL



**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"QUANTUM TRINITY"¹ SHPK**

Sot me daten 31.10.2018 Dymijetetembedhjetë (31.01.2018) në Durres në studion time noteriale të ndodhur në lgj.2 rruga "A.GOGA" para meje Noteres publike BLERTA H.PEKU(ELEZI) anetare e Dhomes së Notereve Durres janë të pranishëm :

1. **Zaccaria CASCONE, atesia Alfonso** i datelindjes **02.10.1960** lindur në Marcianise (CE) Itali dhe banues në Capodrise (CE) rruga D.Cirillo, 11 cap 81020 me shtetësi italiane mbajtes i pasaportes nr.AA4104503 date 19.03.2009 leshimi e vlefshme deri në date 18.03.2019 leshimi.
2. **Francesco RAUCCI, atesia Saverio** i datelindjes **29.05.1969** lindur në Marcianise (CE) Itali dhe banues në rruga De Sanctis, 90 cap 81025 me shtetësi italiane mbajtes i pasaportes nr.YA7418687 date 26.02.2015 leshimi e vlefshme deri në date 25.02.2025.
3. **Figiri KLLARI, atesia Ramazan** i datelindjes **21.02.1954** lindur në Borake, Durres dhe banues në Shijak mbajtes i Leternjoftimit nr.027823274 date 01.11.2009 leshimi (F40221003G).

Te lartpermendurit madhore dhe me zotesi të plote juridike e për të vepruar, bien dakord dhe percaktojnë si vijon :

NENI 1

Themelohet prej tyre Shoqeria me pergjegjesi të kufizuar e cila do të ketë emertimin :
"QUANTUM TRINITY" SHPK.

Shoqeria "QUANTUM TRINITY" SHPK gëzon statusin e *Personit Juridik* shqiptar dhe si e tillë në respektim të neneve 24-38 të K.Civil si dhe të Ligjit nr.9723 date 03-05-2007 "Për Qendren Kombetare të Regjistrimit" ndryshuar me Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015, *fiton personalitet juridik* e për pasoje do të fillojë aktivitetin e saj tregtar pas regjistrimit në QKB (Qendra Kombetare e Bisnesit) si dhe në organet tatimore, në zbatim të neneve 20/1,26,28,32,35 të kësaj ligji .

Aktiviteti i shoqerisë do të zhvillohet në respektim të kësaj AKT-THEMELIMI si dhe STATUTIT që i bashkelidhet kësaj akti, si dhe në përputhje me Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare nr.9901 date 14-04-08 Pjesa IV nenet 68 – 104, i ndryshuar si edhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Shoqeria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për nje kohezgjatje të pakufizuar.

NENI 2


Objekti i veprimtarisë tregtare

¹ Bazuar në nenin 24 të ligjit për QKB është bërë rezervimi e emrit të shoqerisë (CN646946)

Alfonso Cascione

Figiri Kllari

Francesco Raucci


Shoqëria **"QUANTUM TRINITY"** SHPK ka per objekt kryesor te veprimtarise se saj aktivitetet e meposhtme :

Import dhe eksport të kafesë së pjekur në formë kokërr, filter dhe kapsule, tregtimin me shumicë dhe pakicë të produkteve të lartpërmendura, si dhe shitjen dhe shërbimin e aparateve të kafesë ekspres si dhe produkte të tjera të ngjashme apo percjellëse sic janë aksesoret për shërbimin e kafesë dhe pjesë rezerve të aparatëve të kafesë ekspres. Import eksport, tregti me shumicë dhe pakice i kafesë dhe pjekje kafeje.

Kjo shoqëri ne kuader te realizimit te objektit te saj tregtar, duke respektuar ne cdo rast kufizimet ligjore ligjore, mund te kryeje edhe veprimtari te tjera tregtare si:

-Import dhe eksport mallrash të tjera ushqimore, duke vlerësuar interesin e aktivitetit tregtar sipas legjislacionit në fuqi.

-Tregtimin e mallrave me shumicë dhe me pakicë në Republikën e Shqipërisë.

-Hapjen e ambjenteve për ekspozimin e kafesë, dhënien me qira të ambjenteve në disponim të tyre në shërbim të objektit të veprimtarisë, krijimi i pikave të distribucionit në të gjithë territorin.

-Shpërndarja dhe furnizimi me kafe të klientëve të këtij produkti, me mjetet përkatëse të shoqërisë.

-Shpërndarja, instalimi, shitja apo dhënia në përdorim i ekspresëve të kafesë, për bar restorante si dhe ambjente më të vogla biznesi apo banimi.

-Pjekja dhe përpunimi i kafesë në fabrikat përkatëse për kryerjen e këtij procesi sipas standartave të përcaktuara nga ligji Nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

-Trajnimi i duhur profesional për proceset e tharjes, përpunimit dhe paketimit të kafesë.

Ne funksion te aktivitetit te saj te cituar me lart, shoqëria mund te kryeje edhe import & eksport te produkteve, pajisjeve, materialeve qe i sherbejne ushtrimit te aktivitetit po edhe te cfaredo lloji tjeter mallrash qe mundeson kete aktivitet dhe cdo veprimtari tjeter tregtare te ndermarre prej saj ne vijim.

Kurdo dhe ne cdo moment qe do ta vleresoje si me te duhur, shoqëria mund te ushtroje secilen nga veprimtarite e meposhtme :

-transport vendas dhe nderkombetar mallrash dhe udhetaresh per llogari te vet ose te te treteve;

- hapje te agjencive turistike dhe te udhetimeve;


-agjenci imobiliare;

-import& eksport per llogari te vet ose te te treteve si aktivitet me vete.

-veprimtari ne fushen e ndertimit.

Pavaresisht parashikimeve te mesiperme shoqëria eshte e lire te ushtroje cfaredo lloj tjeter veprimtarie tregtare, te lejuar nga ligji shqiptar dhe vetem ne perputhje me parashikimet e ketij te

Beone Zeceiri Francesco Rucci
Beone Zeceiri Francesco Rucci


fundit, proces per te cilin do te mjaftoje vendimarrja e ortakeve te saj sipas procedurave te percaktuara ne statut dhe ne ligjin tregtar shqiptar.

Kjo shoqeri do ta ushtroje aktivitetin e saj kete duke zbatuar te gjitha kufijte dhe hapesirat ligjore qe parashikon ligji i fushes ne Republiken e Shqiperise. Ne kete kuptim kjo shoqeri do te operoje ne tregun shqiptar duke pasur ne baze te veprimtarise tregtare te saj respektimin e ligjit si dhe realizimin e te gjitha veprimeve ligjore e procedurale qe mundesojne kryerjen e kesaj veprimtarie tregtare, duke shfrytezuar ne cdo rast potencialin e saj teknik dhe financiar. Ne kete kuader shoqeria do te respektoje te gjitha normat dhe kushtet e tregut shqiptar ne kete fushë.

• Ne funksion te veprimtarise se mesiperme shoqeria merr persiper te mundesojte me mjetet e veta financiare realizimin e ketij aktivitetit duke respektuar ne cdo rast ligjin e fushes. Shoqeria mund te zgjeroje e ndryshoje ne cdo kohe, pas regjistrimit te saj sipas ligjit, objektin e veprimtarise, duke respektuar parashikimet perkatese ne statut dhe ne ligjin tregtar.

Shoqeria mund te operoje finaciarisht me qellim investimi te sigurte qofte me mjetet e saj financiare, qofte duke marre pjese me kapitalin e saj (pjeserisht ose teresisht) ne kapitalin e shoqerive te tjera shqiptare ose te huaja, dhe duke vepruar ne menyre operative ne shoqeri joint venture (bashkepunimi) ne shoqeri te perziera, shoqata apo grupime te perkohshme ndermarjesh te medha ose te vogla. Ajo mund te jape financime ne forma te ndryshme ne favor te shoqerive te grupit ku ben pjese ose te shoqerive te tjera brenda normave ligjore, me perjashtim te cfaredo lloj raporti me publikun. Gjithashtu mund te bleje kuota pjesemarrjeje ne shoqeri te tjera, ente apo ndermarrje me qellim te nje investimi te qendrushem duke ushtruar keshtu rolin e shoqerise drejtuese te grupimit.

• Ne kuader te objektit te veprimtarise se saj tregtare shoqeria mund te ofroje financime te ndryshme nga kuotimet e saj ne favor te shoqerive te grupit ku ajo ben pjese, kur eshte rasti i tille, ose ne favor te shoqerive te tjera qe operojne ne fushen tregtare, e bere kjo ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi ,por ne asnje rast nuk mund te ofroje kuotat e saj si mjete investimi per publikun e gjere si dhe cdo lloj raporti tregtar me te (publikun) kufizim ky i percaktuar ne menyre eksplicite ne nenin 68/3 I Ligjit nr.9901 dt.14-04-08 "Per shoqerite Tregtare" pjesa IV. Shoqeria gjithashtu mund te kryeje te gjitha llojet e transaksioneve tregtare, industriale, shitje pasurish te luajtshme apo te paluajtshme, qe do te gjykohen te nevojshme apo ne interes terealizimit te objektit te veprimtarise tregtare nga ana e saj, perfshire edhe leshimin e garancive(dorezani, peng) apo te tjera garanci personale e/ose reale ne favor te te treteve , qofte edhe veprime te karakterit pa shperblim kur nuk demtohen interesat e saj.

NENI - 3

Per permbushjen e objektit te veprimtarise se saj, shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo ne valuta te tjera prane bankave shqiptare apo me kapital te huaj, duke pasur keshtu te drejten e disponimit lirisht te mjeteve monetare te akumuluar ne to duke respektuar ne cdo rast legjislacionin ne fuqi.

NENI - 4

Shoqeria "QUANTUM TRINITY" SHPK ka te drejte qe te çele dege filiale si dhe zyra perfaqesimi ne rrethe te ndryshme te Republikes Shqiperise dhe jashte saj duke zhvilluar aktivitetin e saj brenda dhe jashte vendit, veprim per te cilin do te nevojitet natyrisht vendimi i asamblese se ortakeve ose ne rast ndryshimi te raporteve te ortakerise ne shoqeri, sipas ligjit dhe

Corone *Leone* *Francesco Ricci*

dokumenteve themeltare te kesaj Shoqerie(Akt-Themelimi dhe Statut) do te nevojitet vendimi i ortakut te vetem (nese shoqeria mbetet me nje ortak).

NENI - 5
AFATI I VEPRIMTARISE

Shoqeria **"QUANTUM TRINITY" SHPK** do ta ushtroje aktivitetin e saj tregtar per nje kohezgjatje te pakufizuar.

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete **100.000(njeqindmije) ALL** i cili do te derdhet prane njeres prej bankave te nivelit te dyte qe operojne ne R.SH. Ky kapital mund te shtohet ose te pakesohet prej ortakut te shoqerise (apo ortakeve nese ne te ardhmen do te kete)sipas ligjit dhe dokumenteve themeltare te kesaj Shoqerie (Akt-Themelimi dhe Statut) dhe per kete do te nevojitet vendimi i Asamblese se peergjithshme,sipas kushteve te realizimit te qellimit te fitimit.. Kapitali themeltar zoterohet teresisht **nga ortaket themelues**, dhe sipas ligjit pranohete nenshkruar prej ketij te fundit si vijon ;

1-Zaccaria CASONE zoteron 1(nje) kuote me vlere totale 25.000(njezetepesemije) ALL ose 25% te kapitalit themeltar (pjesemarrja ne perqindje).

2-Francesco RAUCCI zoteron 1(nje) kuote me vlere totale 25.000 (njezetepesemije) ALL ose 25% te kapitalit themeltar (pjesemarrja ne perqindje).

3-Fiqiri Killari zoteron 1(nje) kuote me vlere totale 50.000(pesedhjetemije) ALL ose 50% te kapitalit themeltar (pjesemarrja ne perqindje).

NENI 7
VULA E SHOQERISE

Shoqeria **"QUANTUM TRINITY " SHPK** do te kete vulen e saj, permbajtja e se ciles do te jete **"QUANTUM TRINITY " SHPK si dhe do te permbaje numrin e NIPT me te cilin shoqeria do te pajiset ne vijim sipas ligjit .**

NENI 8

Shoqeria ka te drejte qe te ushtroje aktivitetin e saj me ortaket themelues si edhe duke pranuar ortake te tjere sipas akteve ligjore ne fuqi.

NENI 9-SELIA

Selia e Shoqerise do te jete ne adresen : **L.3 Sheshi Iliria, Qendra EGT Durrës, hyrja 1 Ap.N 58 pasuria nr.3/319-N58 vol 14 dhe faqe 38 zk-8514.**

NENI 10

Organet e Shoqerise dhe vendimarrja

Bazuar ne ligjin tregtar dhe ne kete Akt Themelimi,organet e shoqerise jane **Asambleja e Pergjithshme dhe administratoret.** Thirrja dhe vendimarrja e Asamblese behet ne perputhje me percaktimet e neneve 81-90 te ligjit tregtar, perfshire edhe parashikimet per kuorumin ne vendimarrje(neni 86)Te gjitha vendimet e marra prej Asamblese se Ortakeve jane te vlefshme kur merren me duhet te regjistrohen ne nje regjister te vendimeve te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Cosme Zaccaria Francesco Raucci

Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar vetem ne to :

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve
- c) investime.
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kunderdrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte patur dijeni per te. Ortaket/orkatu mund te perfaqesohen/het ne Asambelen e Pergjithshme ne baze te nje autorizimi, nga nje ortak tjetër ose nje person i trete. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme. Autorizimi duhet te jete me shkrim dhe vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme dhe eshte i vlefshem edhe per mbledhjet vijuese nese kane te njejtin rend dite (neni 12 i ligjit 129/2014).

NENI - 11 ADMNISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria ka *Administrator* te saj z.Zaccaria Cascone i cili ka te drejte qe te perfaqesojë dhe te administrojë vete shoqerine per nje mandat 5 vjecar nga data e regjistrimit te shoqerise. Ai ka te drejten e perfaqesimit te shoqerise ne maredheniet juridike me te tretet si edhe para organeve administrative, ligjore, gjyqesore te pushtetit vendor lokal dhe qendror etj, te drejte te cilen mund ta ushtroje si personalisht ashtu edhe nepermjet autorizimit me prokure ose ne cfaredo forme tjetër autorizimi ligjor te personave te tjere, per veprime te vecanta qe lidhen me administrimin. Keta te fundit mandatohen me afat jo me shume se 5 vjet, te percaktuar ne aktin e perfaqesimit leshuar ne favorin e tyre. Perfaqesuesi ligjor (bazuar ne nenin 3 te Ligjit nr.129/2014 date 02.10.2014 "Per disa ndryshime ne ligjin per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" mbetet i detyruar ndaj shoqerise per te zbatuar te gjitha kufizimet e tagreve te perfaqesimit ne maredheniet me te tretet te percaktuara ne Akt-Themelimi dhe Statut apo te miratuara nga organet e shoqerise dhe keto te fundit (Statuti apo vendimet e shoqerise) nuk mund te ndryshojne apo te kufizojne kompetencat qe ligji , cituar edhe me lart percakton per organet e ndryshme te shoqerise tregtare.

Ne ushtrim te tagrit te administrimit bazuar ne kete AKT-THEMELIMI, administratori gezon te drejten e veprimtari ne menyre te pakufizuar sa i takon veprimeve qe lidhen me administrimin e veprimtarise se shoqerise tregtare .

Administratori kryen veprime administrimi te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare ; perfaqeson shoqerine tregtare ne maredheniet me te tretet ne cdo rast ; kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise; pergatit dhe paraqet per nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise ; perzgjedh ekspertin kontabel per ndjekjen e bilancit dhe pasqyrimin e tij me akt –bilanci duke ia paraqitur per miratim emrin e tij Asamblese se Ortakeve e cila vendos per pranimin ose jo te tij ; krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise si dhe ekzistencen e shoqerise ; kryen regjistrimet e detyrueshme dhe ato vullnetare te shoqerise ashtu sikurse parashikohet ne ligjin per QKB ; kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut ; lidh kontrata punesimi me afat ose pa afat me individe, specialiste te kualifikuar ose jo qe sipas rastit ajo gjykon se do ti sherbejne mbarevajtjes se veprimtarise se shoqerise apo qe i konsideron te domosdoshme per ecurine e punes se saj. Gjithashtu mund te vere ne levizje instanca ligjore, gjyqesore dhe administrative te cdo niveli , duke nominuar perfaqesues ligjore me prokura te posacme ose te pergjithshme sipas rastit, per gjykime civile, penale, administrative, per kryerje te operacioneve bankare, hapje llogarish rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, terheqje dhe derdhje me lek ose valute te huaj cash apo me urdher-xhirimi e tituj krediti, paradhenie e kredi. Derdh kapitalin social ne banke dhe kryen veprime qe i takojne nje administrimi te zakonshem dhe te jashtezakonshem me nje limit financiar i cili sipas vullnetit te ortakeve themelues, do te jete i pacaktuar.

Coscone Zaccaria Francesco Roucci
Jan P...



NENI 12

Viti ekonomik fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.Viti i pare ekonomik mbyllet me **31 Dhjetor 2018**.

NENI 13

Ne nje liber te posacem te shoqerise shenohet kapitali shoqeror dhe vlera totale e kontributeve te ortakeve.Ortakete shoqerise mund ta zmadhojne kontributin e tyre dhe per pasoje edhe kuoten pjesemarrese ne shoqeri,duke depozituar fitimet nga aktiviteti i shoqerise konforme pershkrimt te Statutit te shoqerise. Ne perfundim te vitit ekonomik sipas percaktimit me lart, ortakët vendosin per ndarjen e fitimit neto, pasi jane ndare fondet per likuidimin e detyrimeve ndaj te treteve,detyrimet tatimore dhe cfaredo detyrimi fiskal,rezervat e detyrueshme, fitim ky qe mund te disponohet lirisht nga ortakët dhe te transferohet edhe jashte Shqiperise, duke respektuar legjislacionin ne fuqi.Per humbjet pergjigjet eskuzivisht shoqeria me kapitalin e saj.

NENI 14

Ortakët, administratori si edhe eksperti kontabel i miratuar jane te detyruar per ruajtjen e sekretit si mbi dokumentacionin dhe te dhenat e shoqerise, ashtu edhe mbi njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise. Ata duhet te marrin masat e nevojshme te siguroje sa i takon evitimit te perhapjes qofte edhe pjeserisht te tyre. Ne kete menyre ata konsiderohen pergjegjes per pasojat e mundshme negative nga shkelja e detyrimeve te mesiperme .Njekohesisht Ortakët jane pergjegjes ndaj te treteve edhe sa i takon demeve qe mund tu shkaktohen atyre nga anulimi apo deklarimi i pavlefshem i ketij akti themelimi.

Si themelues i kesaj shoqerie, ortakët e saj do te zbatoje te gjitha rregullat, ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi si dhe te gjithë legjislacionin per shoqerite tregtare.

Akti i themelimit redaktohet ne kater ekzemplare origjinale secili .Nenshkrimi i tij u be në praninë time pa vërejtje nga ortakët themelues, pasi ju lexua permbajtja me ze te larte prej meje dhe u gjet ne perputhje me vullnetin e shprehur, pa verejtje, duke vënë emrin dhe mbiemrin original, formë nënshkrimi kjo sipas nenit 46/1 të Ligjit Nr.7829,datë 01.06.1994 “Per Noterine” i ndryshuar ligj me cilesine e njohur prej te cilit unë vërtetoj si për korrektësi në përmbajtje ,ashtu edhe për origjinalitet në nënshkrim te pjesemarrësve ne akt. Me kerkesen e te sipercituarve dhe aprovimin tim, u be peronalisht prej meje perkthimi i permbajtjes se aktit ne giuhen italiane si oralisht ashtu edhe me shkrim dhe vertetohet nga une sipas ligjit.

Ne zbatim te ligjit nr.9887 date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale” konkretisht neneve 2-39 informova te sipercituarit mbi perpunimin e te dhenave personale ne ushtrim te detyrimit ligjor per shkak te funksionit qe kryen Noteri dhe mora deklarimin e tij se jane te pergjegjshem persa me siper dhe aprovojne perpunimin e te dhenave sipas ligjit. Bashkelidhur ketij akti, Statuti i Shoqerise.

Per “ **QUANTUM TRINITY** ” SHPK

Ortakët themelues

1.Zaccaria CASCONE

Cascione Zaccaria

2.Francesco RAUCCI

FRANCESCO RAUCCI

3.Fiqiri KLLARI

Fiqiri Kllari



STATUT

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"QUANTUM TRINITY" SHPK**

KREU I : EMERTIMI – SELIA- KOHEZGJATJA-OBJEKTI-VULA

NENI 1

1)EMERTIMI : Themelohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar nen emertimin "**QUANTUM TRINITY**" SH.P.K

Shoqeria "**QUANTUM TRINITY**" SHPK gezon statusin e *Personit Juridik* shqiptar dhe si e tille ne respektim te neneve 24-38 te K.Civil si dhe te Ligjit nr.9723 date 03-05-2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ndryshuar me Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015, **fiton personalitet juridik** e per pasoje do te filloje aktivitetin e saj tregtar pas regjistrimit ne QKB(Qendra Kombetare e Bisnesit) si dhe ne organet tatimore, ne zbatim te neneve 20/1,26,28,32,35 te po ketij ligji .

Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet ne respektim te ketij AKT-THEMELIMI si dhe STATUTIT qe i bashkelidhet ketij akti, si dhe ne perputhje me Ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare nr.9901 date 14-04-08 Pjesa IV nenet 68 – 104, i ndryshuar si edhe legjislacionin perkates ne fuqi.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per **nje kohezgjatje te pakufizuar.**

2) SELIA – 1. Shoqeria do te kete seline e saj ligjore.

Selia e Shoqerise do te jete ne adresen : **L.3 Sheshi Iliria, Qendra EGT Durres, hyrja 1 Ap.N 58 pasuria nr.3/319-N58 vol 14 dhe faqe 38 zk-8514** adrese qe do te perputhet me ate te regjistruar prane QKB (sipas ligjit per kete te fundit) .Selia administrative do te jete po ne te njejten adrese.

2.Transferimi i selise brenda qytetit/njesise administrative, mund te vendoset nga organi administrativ dhe nuk do te sjelle modifikim/ ndryshim te statutit.

2.Me vendim te organit administrativ, shoqeria mund te hape agjensi si dhe zyra perfaqesimi ne rrethe te ndryshme,nderkohe qe per krijimin e filialeve sekondare eshte i nevojshem vendimi i ortakeve,veprim pas te cilit ajo mund te zhvilloje aktivitetin e saj brenda dhe jashte vendit .

NENI 2

AFATI I VEPRIMTARISE(KOHEZGJATJA)

Shoqeria "**QUANTUM TRINITY**" SHPK do ta ushtroje aktivitetin e saj tregtar per nje **kohezgjatje te pakufizuar.**

NENI - 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria "**QUANTUM TRINITY**" SHPK ka per objekt kryesor te veprimtarise se saj aktivitetet e meposhtme :

Import dhe eksport të kafesë së pjekur në formë kokërr, filter dhe kapsule, tregtimin me shumicë dhe pakicë të produkteve të lartpërmendura, si dhe shitjen dhe shërbimin e aparateve të kafesë ekspres si dhe produkte të tjera të ngjashme apo percjellëse sic janë aksesoret për shërbimin e kafesë dhe pjesë rezerve të aparatëve të kafesë ekspres. Import eksport, tregti me shumicë dhe pakice i kafesë dhe pjekje kafeje.

Codeone Zeccon Francesco Ranci

Kjo shoqëri ne kuader te realizimit te objektit te saj tregtar, duke respektuar ne cdo rast kufizimet ligjore ligjore, mund te kryeje edhe veprimtari te tjera tregtare si:

-Import dhe eksport mallrash të tjera ushqimore, duke vlerësuar interesin e aktivitetit tregtar sipas legjislacionit në fuqi.

-Tregtimin e mallrave me shumicë dhe me pakicë në Republikën e Shqipërisë.

-Hapjen e ambjenteve për ekspozimin e kafesë, dhënie me qira të ambjenteve në disponim të tyre në shërbim të objektit të veprimtarisë, krijimi i pikave të distribucionit në të gjithë territorin.

-Shpërndarja dhe furnizimi me kafe të klientëve të këtij produkti, me mjetet përkatëse të shoqërisë.

-Shpërndarja, instalimi, shitja apo dhënia në përdorim i ekspresëve të kafesë, për bar restorante si dhe ambjente më të vogla biznesi apo banimi.

-Pjekja dhe përpunimi i kafesë në fabrikat përkatëse për kryerjen e këtij procesi sipas standartave të përcaktuara nga ligji Nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

-Trajnimi i duhur profesional për proceset e tharjes, përpunimit dhe paketimit të kafes.

Ne funksion te aktivitetit te saj te cituar me lart, shoqeria mund te kryeje edhe import & eksport te produkteve, pajisjeve, materialeve qe i sherbejne ushtrimit te aktivitetit po edhe te cfaredo lloji tjetër mallrash qe mundeson kete aktivitet dhe cdo veprimtari tjetër tregtare te ndermarre prej saj ne vijim.

Kurdo dhe ne cdo moment qe ajo do ta vleresoje si me te duhur, shoqeria mund te ushtroje secilen nga veprimtarite e meposhtme :

-transport vendas dhe nderkombetar mallrash dhe udhetaresh per llogari te vet ose te te treteve;

- hapje te agjencive turistike dhe te udhetimeve;

-agjenci imobiliare;

-import& eksport per llogari te vet ose te te treteve si aktivitet me vete.

-veprimtari ne fushen e ndertimit.

Pavaresisht parashikimeve te mesiperme shoqeria eshte e lire te ushtroje cfaredo lloj tjetër veprimtarie tregtare, te lejuar nga ligji shqiptar dhe vetem ne perputhje me parashikimet e ketij te fundit, proces per te cilin do te mjaftoje vendimarrja e ortakeve te saj sipas procedurave te percaktuara ne statut dhe ne ligjin tregtar shqiptar.

Kjo shoqeri do ta ushtroje aktivitetin e saj kete duke zbatuar te gjitha kufijte dhe hapesirat ligjore qe parashikon ligji i fushes ne Republikën e Shqiperise. Ne kete kuptim kjo shoqeri do te operoje ne tregun shqiptar duke pasur ne baze te veprimtarise tregtare te saj respektimin e ligjit

Ces come Lorenza Francesca Roucci.

si dhe realizimin e te gjitha veprimave ligjore e procedurale qe mundesojne kryerjen e kesaj veprimtarie tregtare, duke shfrytëzuar ne cdo rast potencialin e saj teknik dhe financiar. Ne kete kuader shoqeria do te respektojte te gjitha normat dhe kushtet e tregut shqiptar ne kete fushe.

• Ne funksion te veprimtarise se mesiperme shoqeria merr persiper te mundesoje me mjetet e veta financiare realizimin e ketij aktivitetit duke respektuar ne cdo rast ligjin e fushes.

Shoqeria mund te zgjeroje e ndryshoje ne cdo kohe, pas regjistrimit te saj sipas ligjit, objektin e veprimtarise, duke respektuar parashikimet perkatese ne statut dhe ne ligjin tregtar.

Shoqeria mund te operoje finaciarisht me qellim investimi te sigurte qofte me mjetet e saj finaciare, qofte duke marre pjese me kapitalin e saj (pjeserisht ose teresisht) ne kapitalin e shoqerive te tjera shqiptare ose te huaja, dhe duke vepruar ne menyre operative ne shoqeri joint venture (bashkepunimi) ne shoqeri te perziera, shoqata apo grupime te perkohshme ndermarrjesh te medha ose te vogla .Ajo mund te jape financime ne forma te ndryshme ne favor te shoqerive te grupit ku ben pjese ose te shoqerive te tjera brenda normave ligjore,me perjashtim te cfaredo lloj raporti me publikun.Gjithashtu mund te bleje kuota pjesemarrjeje ne shoqeri te tjera,ente apo ndermarrje me qellim te nje investimi te qendrueshem duke ushtruar keshtu rolin e shoqerise drejtuese te grupimit.

• Ne kuader te objektit te veprimtarise se saj tregtare shoqeria mund te ofroje financime te ndryshme nga kuotimet e saj ne favor te shoqerive te grupit ku ajo ben pjese, kur eshte rasti i tille, ose ne favor te shoqerive te tjera qe operojne ne fushen tregtare, e bere kjo ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi ,por ne asnje rast nuk mund te ofroje kuotat e saj si mjete investimi per publikun e gjere si dhe cdo lloj raporti tregtar me te (publikun) kufizim ky i percaktuar ne menyre eksplicite ne nenin 68/3 I Ligjit nr.9901 dt.14-04-08 "Per shoqerite Tregtare" pjesa IV.

Shoqeria gjithashtu mund te kryeje te gjitha llojet e transaksioneve tregtare, industriale, shitje pasurish te luajtshme apo te paluajtshme, qe do te gjykohen te nevojshme apo ne interes te realizimit te objektit te veprimtarise tregtare nga ana e saj, perfshire edhe leshimin e garancive (dorezani, peng) apo te tjera garanci personale e/ose reale ne favor te te treteve, qofte edhe veprime te karakterit pa shperblim kur nuk demtohen interesat e saj.

NENI 4

Per permbushjen e objektit te vepritarise se saj,shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo ne valuta te tjeraprane bankave shqiptare apo me kapital te huaj, te nivelit te dyte, duke pasur keshtu te drejten e disponimit lirisht te mjeteve monetare te akumuluar ne te duke respektuar ne cdo rast legjislacionin ne fuqi.

NENI 5

VENDBANIMI I ORTAKUT/EVE

1.Vendbanimi i ortakeve sa i takon te gjitha raporteve me shoqerine,eshte ai qe rezulton nga libri i ortakeve.

2.Eshte detyrim i tyre ti komunikojne shoqerise me qellim regjistrimin ne librin e ortakevedhe numrin e faxit dhe adresen elektronike.Ne mungese te ketij veprimi nuk do te jete e mundur perdorimi i ketyre formave te komunikimit ne favor te ortakeve.

NENI 6 - VULA

Shoqeria "QUANTUM TRINITY " SHPK do te kete vulen e saj, permbajtja e se ciles do te jete "QUANTUM TRINITY "SHPK si dhe do te permbaje numrin e NIPT me te cilin shoqeria do te pajiset ne vijim sipas ligjit.

Colson Jace
Francisco Rucci
Tom Rucci

KREU II
KAPITALI THEMELTAR DHE NDARJA NE KUOTA

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete **100.000(njeqindmije) ALL** i cili do te derdhet prane njerës prej bankave te nivelit te dyte qe operojne ne R.SH. Ky kapital mund te shtohet ose te pakesohet prej ortakeve te shoqerise (apo ortakeve nese ne te ardhmen do te kete)sipas ligjit dhe dokumenteve themeltare te kesaj Shoqerie(Akt-Themelimi dhe Statut) dhe per kete do te nevojijet vendimi i Asamblese se peergjithshme, sipas kushteve te realizimit te qellimit te fitimit. Kapitali themeltar zoterohet teresisht nga ortaku themelues, dhe sipas ligjit pranohet e nenshkruar prej ketij te fundit si vijon ;

1-Zaccaria CASCONI zoteron 1(nje) kuote me vlere totale 25.000(njetepesemije) ALL ose 25% te kapitalit themeltar (pjesemarrja ne perqindje).

2-Francesco RAUCCI zoteron 1(nje) kuote me vlere totale 25.000 (njetepesemije) ALL ose 25% te kapitalit themeltar (pjesemarrja ne perqindje).

3-Fiqiri Kllari zoteron 1(nje) kuote me vlere totale 50.000(pesedhjetemije) ALL ose 50% te kapitalit themeltar (pjesemarrja ne perqindje).

KREU III
TRANSFERIMI I PJESEVE NOMINATIVE(KUOTAVE)
TE KAPITALIT THEMELTAR

NENI 8

Shoqeria ka te drejte te transferoje kapitalin duke respektuar format e lejuara nga ligji material (Ligji nr.9901 date 14.04.08, i ndryshuar)dhe aktet themeltare.Qe nenkupton se ortaket themelues sipaspjesemarrjes ne perqindje ne kapitalin e shoqerise(apo kuotes) gezojne te drejten qe pjeset e kapitalit themeltar(kuoten perkatese) ti transferojne tek te tretet. Gjithashtupjeset(kuotat) e kapitalit themeltar jane lirisht te trasferueshme ne rruge trashegimie si dhe ne raste ndarje pasurore te bashkeshorteve.

Ortaket themelues vendosin gjithashtu qe, ne rast te ndryshimit te raportit te pjesemarrjes ne **kapitalin e shoqerise**, secili ortak gezon respektivisht **te drejten e parablerjes se kuotes/ave** te zoteruara ose **te pjeseve ne kuota**, ne rast te shitjes se tyre tek te trete.Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar (kuotes/ave) tek te tretet behet me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar,konforme procedures si vijon:

Ortaku qe kerkon te trasferoje kuoten e tij te treteve teresisht apo pjeserisht, eshte i detyruar qe fillimisht ti rezervoje ortakeve te tjere te drejten e parablerjes.Per te lejuar ushtrimin e kesaj te drejte,ortaku qe deshiron te transferoje kuoten e tij, duhet te lajmeroje me leter rekomande te gjithë ortaket qe figurojne ne librin e ortakeve(ne shtepine e secilit,me adresat qe rezultojne ne kete liber) duke e specifikuar cmimin e shitjes,menyren e pageses dhe emrat e bleresve te mundshem.

Nese letra rekomande nuk i arrin marresit,ajo do te konsiderohet e mberritur nga te dy palet, ne daten kur postieri konfirmon daten e dorezimit ne adresen e percaktuar ne liber.

Pergjigja e ofertes per te ushtruar te drejten e parablerjes duhet t'i arrije ortakut ofrues me leter-rekomande brenda 30 diteve nga data qe ortaku i interesuar ka marre njoftimin me oferten e shitjes.

Ne rast se Asambleja refuzon(me shkrim) dhenien e miratimit,ortaku/et brenda tre muajve nga data e refuzimit eshte/jane te dertyruar te bejne apo te lejone blerjen ne favor te bleresit te caktuar nga ortaku/et ofertes, me te njetin cmim dhe ne te njetjen menyre qe ky i fundit ka vendosur ne njoftim.

Cascone Zaccaria *Francesco Raucci*
P *Franco*



NENI 9

Kapitali themeltar do te depozitohet prane njeres nga bankat e nivelit te dyte qe operojne ne R.Shqiperise ku edhe do te celet llogaria rrjedhese e kesaj shoqerise.

NENI 10

Kapitali themeltar mund te ndryshohet me vendim te Ortakevethemelues,cfare do te thote qe ai mund te zmadhohet ose te zvogelohet ne vlere.Depozitimi i vleres se shtuar te kapitalit behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve dhe shenohet ne regjistrin e veprimeve te vecanta te shoqerise.Gjithashtu ky veprim eshte i detyrueshem per regjistrim prane QKB.

Kur si rezultat i humbjeve nga aktiviteti i shoqerise, zvogelimi i kapitalit eshte i pashmangshem,nese ky zvogelim behet nen vleren minimale te parashikuar nga ky AKT-**THEMELIMI** bazuar ne Ligjin 9901 date 14-04-2008 “Per shoqerite Tregtare” i ndryshuar, shoqeria nis proceduren e falimentimit (neni 99/c I ligjit Kreu I –Prishja e shoqerise).

Gjithashtu ne keto raste shoqeria eshte e detyruar te njoftoje te tretet me te cilet ka maredhenie kontraktore si edhe te beje regjistrimin perkates prane QKB.Ashtu sikurse ajo mund te kete faqen e saj elektronike per komunikimin e te dhenave.Edhe kjo e fundit duhet te regjistrohet prane QKB ne menyre qe tu njoftohet ne kohe te tretteve dhe per pasoje te mos perbeje shkak per pavlefshmeri te veprimeve si pasoje e mungeses se informacionit si dhe tem und tu kunderdrejtohet te tretteve (ne kuptim te ligjit).

NENI 11

Kur vendimi i zvoglimit te kapitalit te shoqerise nuk motivohet nga humbjet ne aktive kreditoret e shoqerise duhen njoftuar menjeheregjithesesata rezervojne te drejten per kundershtimin e vendimit ne rruge gjyqesore.

NENI 12

Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave

Kuoatat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) **kontributit ne kapitalin e shoqerise;**
- b) **shitblerjes;**
- c) **trashegimise;**
- e) **dhurimit;**
- d) **cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.**

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te pronesise mbi kuoten, kushtet e tjera te kalimit perfshire momentin e pageses se cmimit, rregullohen nga kontrata e cila do te jete ne forme shkresore.*Per cdo gje tjeter lidhur me sa me lart do te zbatohen percaktimet e nenit 10 te ligjit nr.129/ 2014 date 02.10.2014 Per disa ndryshime ne Ligjin 9901 date 14.04.08 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare.*

Ne cdo rast kur shoqeria ka me shume se nje ortak, ky kalim kerkon respektimin e te drejtes se parablerjes ne favor te ortakut pjesemarres ne shoqeri apo ne favor te shoqerise.

KREU IV

Administrimi i Shoqerise

Neni 13

Administrator i shoqerise si dhe perfaqesues i saj ne maredhenie me te tretet, do te jete ortaku **z.Zaccaria Cascone** i cili kryen cdo lloj veprimi ligjor qe i takon administrimit te zakonshem dhe jo te zakonshem te shoqerise, veprimet keto te percaktuara ne aktet themeltare te shoqerise dhe qe kryhen prej tij, ne emer dhe per llogari te shoqerise.

Mandatimi i tij per ushtrimin e ketyre funksioneve behet per nje periudhe prej **5 vjetesh** nga data e fitimit te personalitetit juridik te shoqerise pra regjistrimit te saj ne QKB, me te drejte

Cascone Zaccaria Francesco Roumi

riperseritje ,bazuar kjo ne nein 95/1 te ligjit 9901 date 14-04-08 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar dhe si i tille pushon se ekzistuari :

a)ne rast heqje dore ne forme deklarative (me shkrim);

b)kur po me vendim te ortakeve emerohet ne kete funksion nje person tjeter qe nuk eshte ortak i shoqerise;

c)me ndryshimin e Statutit .Kur me vendim te Ortakeve themelues i shitet nje pjese e kuotave nje personi qe behet Ortak ne kete shoqeri,me mareveshje midis ortakeve te rinj dhe me vendim verbal te Asamblese vendoset qe keto funksione te ushtrohen nga njeri prej ortakeve.

ç)me perfundimin e mandatit.

d)si edhe ne cdo rast tjeter kur veprimet e tij perbejne shkelje te rende te dispozitave te ketij Statuti si dhe te Aktit te Themelimit apo jane te denueshme penalisht.

Administratori i shoqerise puneson per nevoja te saj persona te tjere me kontrate konforme ligjeve ne fuqi. Lidh marreveshje me persona te tjere fizike, juridike vendas apo te huaj. Perfaqeson shoqerine ne te gjitha organizmat shteterore ,gjyqesore dhe shoqerore.Ai ka te drejte te beje mareveshje me te tretet sa i takon objektit te veprimtarise se shoqerise dhe brenda kompetencave te deleguara nga ortakut tjeter ne rastin e pikes c te ketij neni.Po ne keto raste nuk mund te beje veprime qe lidhen me blerje apo investime qe e kalojne vleren e kapitalit themeltar te shoqerise ,per te tilla do te jete i domosdoshem pelqimi me shkrim i ortakut tjeter ose ortakeve nese shoqeria ne vijim do te kete te tille.Gjithashtu ka te drejte te marre te dhenadhe te beje propozime per gjithshka qe e cmon te dobishme per shoqerine .Te pergjigjet per demet qe mund ti vijne shoqerise nga veprimet e tij si dhe te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.Te pajtoje ekspertin kontabel te miratuar si edhe cdo person qe do te konsideroje te nevojshem per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.Gjithashtu ka te drejten te lidhe kontrata siper marrje dhe cdo forme tjeter sa i takon ushtrimit te veprimtarise se shoqerise tregtare.

Ne fund te cdo viti ekonomik Administratori ka detyrimin te perpiloje nje relacion mbi aktivitetin e zhvilluar,objektivat e arritura dhe perspektiven e shoqerise si dhe te firmose bilancin perfundimtar te pergatitur nga eksperti kontabel i miratuar(kur eshte rasti te merret nje i tille).

NENI 14

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administrimit te administratorit te saj edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Ajo nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur keta te fundit ishin ne dijeni se akti i administratorit ishte ne tejkalim te objektit te shoqerise si dhe kur te tretet nuk mund te injoronin kete fakt.

NENI 15

Administratori mban pergjegjesi per te gjitha pasojat qe sjell veprimtaria e tij ndaj shoqerise si dhe te treteve.Ai pergjigjet individualisht ose solidarisht,sipas rastit ndaj shoqerise ose te treteve per shkeljet ligjore te Statutit apo *veprime me faj* te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Shoqeria nuk mban pergjegjesi ndaj te treteve per aktivite te kryera nga administratori ne kundershtrim me kompetencat e tij,ne rast se provon se ata ishin dijeni te kesaj rrethane.

NENI 16

Ne cilesine e administratorit apo te perfaqesuesit bashke ose vec e vec, nese kjo cmohet prej ortakeve themelues te saj mund te emerohet edhe ndonje person tjeter .

NENI 17

Administratori gezon te drejte te pakufizuar ne ushtrimin e tagreve te tij ,me perjashtim te atyre qe ky Statut dhe Akti-Themelimit i ndalon ose mund ti ndalojne ne rast te ndryshimit te tyre sipas formes se kerkuar ligjore.Ne funksion te realizimit te detyrave te veta admnistratori mund te vere ne levizje instanca juridike dhe administrative,te mandatoje perfaqesues ligjore dhe te leshoje prokura perfaqesimi,te kryeje operacione bankare,perfshire ketu hapje te llogarive

Adnan Zeceni *Francesco Rucci*

rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceteve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve cash ose me urdher-xhirimi, tituj krediti, paradhenie krediti,

NENI 18

Administratori mund te emeroje perfaqesues duke i mandatuar per veprim individualisht ose kolektivisht duke iu njohur te drejten dhe kompetencat qe ai do ti konsideroje te arsyeshme per tu kryer prej tyre ne funksion te realizimit te veprimatrise tregtare te shoqerise, si dhe numd t'iu jape atyre shperblime dhe garanci sipas rastit qe ai do ta vleresoje kete gje si te arsyeshem. Sikurse mundet te emeroje drejtues apo perfaqesues per akte apo kategori te caktuar veprimesh.

EKSPERTI KONTABEL I MIRATUAR

NENI 19

Aktiviteti financiar i shoqerise do te kontrollohet nga ana e ekspertit kontabel i autorizuar dhe i caktuar nga ortakët themelues me vendim Asambleje .

NENI 20

Eksperti Kontabel i Miratuar ka per detyre te nxjerre bilancin e aktivitetit ekonomik-financiar te shoqerise i cili do te dale cdo tremujor.

NENI 21

Bilanci Vjetor do te dale jo me vone se nje muaj mbas mbarimit te vitit kalendarik. Viti financiar i shoqerise me perjashtim te vitit e vazhdim i cili do te filloje me regjistrimin e shoqerise, fillon me 01 Janar te cdo viti.

NENI 22

Caktimi ose emerimi i nje eksperti kontabel te miratuar behet i detyrueshem kur ne mbyllje te vitit financiar nga aktiviteti i shoqerise tejkalohe dy nga treguesit si vijon:

a. Totali i bilancit ne mbyllje te vitit perkates : 6.000.000(gjashte million) Lek

b. Totali i te ardhurave vjetore : 12.000.000(dymbedhete million) Lek.

c. Numri mesatar i te punesuarve nga shoqeria : 10 (dhjete) persona.

Jane te pavlefshme operacionet tregtare te kryera pa pranine e ekspertit kontabel te miratuar, kur per kryerjen e tyre ligji parashikon domosdoshmerisht pranine e tij si edhe ato veprime qe kryhen ne kundershtrim me kriteret e parashikuara nga ligji 9901 date 14-04-2008 "Per Shoqerite Tregtare" i ndryshuar.

NENI 23

Eksperti kontabel i miratuar pasi ben verifikimin ne librat kontabel, arken dhe depozitat bankare, jep garanci qe bilanci vjetor eshte mbajtur me rregull perputhet me realitetin dhe eshte konforme legjislacionit ne fuqi.

Ai mund te shkarkohet nga funksioni i tij me vendim te Ortakut te Vetem ose te Asamblese ne rastin kur shoqeria eshte me me shume se nje ortak si edhe me vendim gjykate ne rastet e parashikuara nga ligji.

Afati ne detyre i ekspertit kontabel eshte 5 (pese) vite financiare.

Eksperti kontabel perpilon dhe i paraqet Ortakut te Vetem raportin financiar te ushtrimit vjetor qe tregon situaten financiare ne nisje dhe ne mbyllje te aktivitetit tregtar.

Kontrollon qe bilanci perfundimtar dhe raporti I perpiluar nga Administratori te perputhen midis tyre dhe me realitetin tregtar.

Ai ka per detyre t'i paraqese Administratorit dhe kur eshte rasti Asamblese se ortakeve;

1. Kontrolllet, verifikimet dhe sondazhet e kryera prej tij;
2. Zerat e bilancit dhe dokumentacionin kontabel qe duhet korigjuar duke bere sygjerimet e tij dhe duke treguar zgjidhjet profesionalisht;

Edson Jacovici *Francesco Ravici*

3. Gabimet dhe pasaktesite e konstatuara prej tij;
4. Rezultatin financiar pas korigjimeve te bera;

NENI 24

Eksperti kontabel pergjigjet ndaj shoqerise si dhe ndaj te treteve per pasojat e demshme qe mund te vijne nga gabime dhe pakujdesi ne ushtrim te funksionit te tij.
Nuk pergjigjet per shkeljet ligjore te kryera nga Administratori ,me perjashtim te rasteve kur kishte dijeni per to ose nga rrethanat nuk kishte sesi te mos kishte dijeni,si dhe ne rastet e fshehjes(mbulimit) se qellimshme te veprimeve arbitrare dhe ne mashtrim me ligjin.

Maredheniet e Punesimit

NENI 25

Shoqeria ka te drejte te punesoje persona fizike si specialiste ne arritjen e qellimit te fitimit duke zbatuar aktet ligjore mbi punesimin si dhe duke lidhur kontrata pune me secilin te punesuar.

NENI 26

Cdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per plotesimin e detyrimeve qe heq ne baze te kontrates se punes dhe ligjeve ne fuqi.

NENI 27

Per cdo konflikt qe mund te linde midis shoqerise dhe personave te punesuar ne kete shoqeri do te behet perpjekje per zgjidhjen e tyre me mirekuptim midis paleve, ne te kundert organ kompetent per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres.

NENI 28

Shoqeria ka te drejte te vazhdoje aktivitetin e saj duke pranuar edhe ortake te tjere sipas kushteve qe do te parashikohen ne kontrata te ortakerise.

NENI 29

Pasuria e shoqerise perbehet nga mjetet monetare te depozituara ne kohen e krijimit te saj por kjo mund edhe te shtohet me pasuri te tjera ne para ,ne natyre apo burime te tjera financiare.

KREU V

Ndarja e Fitimit,Rezervat

NENI 30

Fitimi i shoqerise "**QUANTUM TRINITY " SHPK** del;

-Pas perballimit te detyrimeve, taksave e tatimeve,shpenzimeve te ndryshme si dhe pagesa e punonjesve te punesuar si dhe perballimit te detyrimeve ndaj te treteve.

-Ortaku i Vetem dhe kur eshte rasti Asambleja, qe aprovojne bilancin duhet te destinoje 1/20 te fitimit vjetor te shoqerise te realizuar per krijimin e nje fondi te emeruar " REZERVE E DOMOSDOSHME".

Ky detyrim nuk vlen per rastin kur "Rezerva e domosdoshme" arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Fitimi qe perbehet nga diferenca midis fitimit vjetor financiar te sapombyllur dhe vleres se fondit "Rezerve e domosdoshme" konforme ketij neni , I kalon ortakut te vetem ose ortakeve kur eshte rasti.

Ortaket me vendim mund te vendosin per formimin e fondeve te tjera dhe menyren e shperndarjes se tyre ,mjafton qe kjo shperndarje te mos sjelle zvogelim te kapitalit ne limitin e parashikuar nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" nr. 9901 date 14-04-08, i ndryshuar .

Col eone *Jocenia* *Francesco Ruccia*
fran

KREU VI

Prishja e Shoqerise, largimi dhe perjashtimi i Ortakut

NENI 31

Shoqeria priset per te gjitha shkaqet e parashikuara nga neni 43 i ligjit nr. 9901 i ndryshuar me nenin 7 te ligjit 129/2014 si :

- a- kur mbaron kohezgjatja per te cilen eshte themeluar,
- b- me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne cdo rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentit ,
- c- ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare,
- d- ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise, te parashikuara nga neni 3/1 i ligjit,
- e- ne rastet e parashikuara nga neni 47 i ligjit,
- f- ne raste te tjera te paashikuara ne statut,
- g- ne raste te tjera te parashikuara ne ligj,
- h- me vendim te ortakeve.

Per prishjen e shoqerise zbatohen dispozitat e parashikuara ne kete statut dhe ne nenin 43/1-6 te ligjit 9901 ndryshuar me nenin 7 te ligjit 129/3014.

NENI 32

Administratori regjistron prishjen e shoqerise prane QKB. Akti i themelimit dhe ky Statut si dhe te gjitha aktet e tjera te Shoqerise mund te konsiderohen te pavlefshem vetem ne rast se vijne ne kundërshtim me dispozitat ligjore te ligjit nr. 9901 date 14-04-08 "Per Shoqerite Tregtare" i ndryshuar dhe Kodin Civil.Ne raste te tilla shoqeria pergjigjet per pasojat qe mund te kene pasur te tretet nga veprimtaria e saj.

NENI 33

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne shoqerite e ndryshme te sigurimeve.

NENI 34

Ortaket themelues fillojne procedurat e likujdimit te shoqerise kur, me vendim gjyqesor shpallet pavlefshmeria absolute apo relative e akteve qe formojne kete shoqeri si edhe ne rastet e parashikuara ne statut. Likujdimi i shoqerise behet duke respektuar dispozitat 190-205 te ligjit 9901 date 14-04-2008 "Per Shoqerite Tregtare" i ndryshuar .Bazuar ne nenin 214- 233 te po ketij ligji shoqeria mund te riorganizohet nepermjet bashkimt me nje shoqeri tjetër,nepermjet ndarjes ne dy apo me shume shoqeri te tjera ose nepermjet shnderrimit te formes ligjore.Sipas nenit 228/a nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te shnderrohet ne shoqeri aksionare dhe anasjelltas.Po sipas ketij ligji shoqerite tregtare qe nuk pershtaten me dispoziat e tij sipas nenit 230/2 te ketij ligji vleresohen te prishura dhe cregjistrohen nga QKB pas perfundimit te procedures se likujdimit.

NENI 35

Statuti i shoqerise "**QUANTUM TRINITY** " **SHPK** perpilohet ne pese ekzemplare origjinale secili.Me mundesine qe te shtohen dispozita te tjera sipas kushteve te zhvillimit te shoqerise dhe akteve ligjore ne fuqi, ky statut i bashkelidhet Aktit-Themelimit te shoqerise dhe se bashku jane **dokumentet themeltare te kesaj shoqerie**.

Nenshkrimi i ketij akti(ne cdo flete) u be në praninë time pa vërejtje nga ortaket themelues, pasi ju lexua permbajtja me ze te larte prej meje dhe u gjet ne perputhje me vullnetin e shprehur, pa verejtje, duke vënë emrin dhe mbiemrin origjinal, formë nënshkrimi kjo sipas nenit 46/1 të Ligjit Nr.7829, datë 01.06.1994 "Per Noterine" i ndryshuar ligj me cilesine e njohur prej te cilit unë

Cosimo Teseoni e Francesco Rucci

vërtetohet si për korrektësi në përmbajtje si edhe për originalitet në nënshkrim të pjesëmarrësve në akt. Me kërkesën e të sipercituarve dhe aprovimin tim, u bë personalisht prej meje perkthimi i përmbajtjes së aktit në gjuhën italiane si oralisht ashtu edhe me shkrim dhe vërtetohet nga une sipas ligjit.


Ne zbatim të ligjit nr.9887 date 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" konkretisht nënve 2-39 informova të sipercituarit mbi përpunimin e të dhënave personale në ushtrim të detyrimit ligjor për shkak të funksionit që kryen Noteri dhe mora deklarinë e tij se janë të përgjegjshëm për sa me sipër dhe aprovojnë përpunimin e të dhënave sipas ligjit. Bashkelidhur këtij akti, Statuti i Shoqërisë.

Ky Statut bashkelidhet me Aktin e Themelimit dhe në total i gjithë materiali ka 16 flete.


Per "QUANTUM TRINITY" SHPK

Ortakët themelues :


1.Zaccaria CASCONE



2.Francesco RAUCCI



3.Fiqiri KLLARI



NOTERE
BLERTA ELEZI (PEKU)

REPUBBLICA D'ALBANIA
CAMERA DEI NOTAI DURAZZO
STUDIO NOTARILE BLERTA ELEZI(PEKU)
Nr. 209 REP
Nr. 61/4 Racc

